



**FAKULTETI I HISTORISË
DHE FILOLOGJISË
(FHF)**



**INSTITUTI I STUDIMEVE
EVROPIANE
(ISE)**

MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIM DHE QASJE TË LIRË NË FONDET ARKIVORE BIBLIOTEKËS TË FHF-SË DHE NË FONDET E ISE-SË

Në kuadër të bashkëpunimit mes njësisë e strukturave të UT-së, dhe në mbështetje të akteve rregullatore që zbatohen në UT, Instituti i Studimeve Evropiane (ISE), UT dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (FHF), i Universitetit të Tiranës (referuar më poshtë si “Palët”) nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i marrëveshjes është lehtësimi i studimeve dhe punës kërkimore për studentët dhe personelin akademik me kohë të plotë të ISE-së, në lidhje me përdorimin e fondit arkivor të bibliotekës së FHF-së dhe anasjellas, ISE do të vërë fondet arkivore e bibliotekare të saj në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të FHF-së.

Biblioteka e FHF-së dhe ajo ISE-së ofrojnë qasje të lirë në informacion dhe ndihmojnë procesin mësimor dhe kërkimin shkencor të studentëve dhe të stafit akademik, si dhe mbështesin veprimtaritë e tjera akademike e kërkimore në përputhje me sa është parashikuar në këtë marrëveshje.

Neni 2 Objekti

Kjo marrëveshje ka si objekt bashkëpunimin midis dy palëve në fushën e aksesit në fondin e bibliotekave gjegjëse, të kërkimit shkencor dhe botimeve, nëpërmjet qasjes së lirë të stafeve akademike dhe studentëve në fondet arkivore dhe krijimit të lehtësirave infrastrukture në mjediset përkatëse.

Neni 3

Aksesi dhe qasja e lirë në fondin arkivor të bibliotekës

1. Biblioteka e FHF-së merr përsipër të mbështesë ISE, dhe anasjellas, me burimet arkivore në formë hard copy dhe digjitale pa pagesë, duke garantuar akses të lirë në to për studentët dhe stafin akademik.
2. Studentët dhe stafi akademik respektiv mund të përdorin pa pagesë ambientet/sallat e bibliotekës dhe të ISE-së, gjatë orarit zyrtar dhe në mirëkuptim me personat përgjegjës.
3. Studentët dhe stafet akademik mund të përdorin infrastrukturën teknologjike të bibliotekës dhe të ISE-së, gjatë orarit zyrtar, në përputhje me rregulloret gjegjëse dhe në pajtim me personat përgjegjës përkatës.
4. Biblioteka e FHF-së, bazuar në këtë marrëveshje, mundëson për studentët dhe personelin akademik me kohë të plotë të ISE-së akses të lirë me kohëzgjatje deri në afatet që lejon rregullorja e saj. Studentët e ISE-së për të vërtetuar statusin e tyre, do t'i paraqesin punonjësve të bibliotekës kartën e studentit ose në mungesë të saj, vërtetim të lëshuar nga ISE. Në mënyrë të njëjtë, ISE-ja mundëson për studentët dhe personelin akademik me kohë të plotë të FHF-së akses të lirë me kohëzgjatje deri në afatet që lejon rregullorja e saj. Studentët e FHF-së do të paraqesin në ISE kartën e studentit ose, në mungesë të saj, një vërtetim të lëshuar nga personat e autorizuar nga autoriteti drejtues i FHF-së.
5. Studentët dhe personeli akademik i dy njësive kryesore të UT-së detyrohet të respektojnë rregulloret e bibliotekave gjegjëse.
6. ISE do t'i dhurojë pa pagesë bibliotekës së FHF-së botimet e nxjerra prej saj në 2 (dy) kopje.

Neni 4

Bashkëpunime të tjera

Palët angazhohen në bashkëpunime të tjera, të tilla si: përdorimi i sallave të bibliotekave gjegjëse për tryeza apo seminare, zhvillimi i praktikave mësimore brenda mundësive dhe kapacitetit të tyre, promovimi i botimeve, si dhe çdo bashkëpunim tjetër të mundshëm me interes të ndërsjellë.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre.

NENI 6

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

1. Marrëveshja ka kohëzgjatje të pacaktuar.

2. Palët mund të kërkojnë mosrinovimin e marrëveshjes për vitin pasardhës vetëm nëse pala tjetër nuk realizon detyrimet e përcaktuara në nenin 3 të saj. Në këtë rast, ato lajmërojnë me shkrim palën tjetër, jo më vonë se data 1 tetor.
3. Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, 2 (dy) për secilën palë, me të njëjtën vlerë.


Tiranë, më ____ / ____ / ____

PËR

FAKULTETIN E HISTORISË DHE

FILOLOGJISË

Prof. Dr. SABRI LAÇI



PËR

INSTITUTIN E STUDIMEVE

EVROPIANE

Prof. Dr. ALJULA JUBANI

